



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 1624/prot.
2

Himarë, më 02.03.2026

NJOFTIM PËR PARAQITJE DOKUMENTACIONI

Në zbatim të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.111/2019 “Për Kadastrën”, VKM-në nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, si dhe në zbatim të vendimit nr.53, datë 31/10/2025 “Për zbatimin e VKM-së nr.329, datë 22/05/2019” të Këshillit Bashkiak Himarë, me qëllim trajtimin e kërkesave të qytetarëve për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim:

Bashkia Himarë njofton, të gjithë subjektet që janë trajtuar me troje për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore pas datës 10.08.1991, por nuk është finalizuar me regjistrim, se do të trajtohen kërkesat e qytetarëve në kuadër të zbatimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.53, datë 31/10/2025 “Për zbatimin e VKM-së nr.329, datë 22/05/2019”, të paraqesin në Bashkinë Himarë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Vendim i këshillit bashkiak/komunal për dhënien e truallit për ndërtim.
- b. Vendim kryepleqësisë për dhënien e truallit.
- c. Planimetri e sheshit të ndërtimit (në vitin që është dhënë).
- d. Planimetri e sheshit të ndërtimit (e tre muajve të fundit).
- e. Kopje e dokumentit të identifikimit (ID).
- f. Certifikatë familjare (nëse trualli është dhënë në emër familjar).
- g. Prokurë noteriale (nëse përfaqësohet nga person i tretë).
- h. Dëshmi trashëgimie (ligjore ose testament) kur jemi në kushtet e trashëgimisë së truallit të dhënë për ndërtim.
- i. Proces verbal piketimi.
- j. Akt vlerësimi të truallit.
- k. Mandat pagese të truallit.
- l. Kontratën shitblerjes së truallit.

- m. Deklarata/dëshmi të kufitarëve.
- n. Çdo dokument tjetër i cili provon lidhjen e subjektit kërkues me truallin e dhënë për ndërtim.
- o. Kërkesa duhet të shoqërohet me plan rilevimi të sipërfaqes së truallit, të hartuar nga një ekspert gjeodet i licensuar.
- p. Dokumentacioni duhet të paraqitet i njësuar me origjinalin.

Të gjithë subjektet që janë trajtuar me troje për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore pas datës 10.08.1991, por nuk është finalizuar me regjistrim, që dëshirojnë të kryerjnë procedurat administrative për njohjen e subjekteve të trajtuar me troje për ndërtim, vijimin me përpilimin dhe nënshkrimin e kontratës tip të shitblerjes të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Himarë dhe përcjelljen për regjistrim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të paraqesin gjithë dokumentacionin e sipërcituar pranë Bashkisë Himarë deri më datë 30.04.2026.

**KRYETARI
VANGJEL TAVO**

